

Lumturije KURTISHAJ

KRIMET E FORCAVE SERBE NË KOMUNËN E MALISHEVËS (1998-1999)

Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, forcat ushtarake dhe policore serbe kanë ushtruar akte të shumta të dhunës ndaj popullatës civile shqiptare në komunën e Malishevës. Këto akte përfshijnë torturë, vrasje, ekzekutime, përdhunime, dëbim me forcë dhe shkelje të tjera të rregullave të luftës, të cilat janë dokumentuar nga organizata të ndryshme të të drejtave të njeriut, si Human Rights Watch dhe Amnesty International. Sipas burimeve të ndryshme, në territorin e komunës së Malishevës, nga janari i vitit 1998 deri më 12 qershor 1999, janë vrarë 317 banorë (270 meshkuj dhe 67 femra), prej tyre 25 të karbonizuar. Këto informacione janë të rëndësishme për të kuptuar përmasat e dhunës dhe pasojat e luftës në Kosovë.¹

Sipas të dhënave në komunën e Malishevës, nga 317 civilët që u vranë dhe u masakruan nga forcat e sigurisë serbe, 70 prej tyre ishin fëmijë me moshë nga 0 deri 18 vjeç (21 femra dhe 49 meshkuj), ku kjo tregon se fëmijët ishin një nga grupet më të prekura nga dhuna e luftës në këtë komunë. Në fakt, sipas raportit të Human Rights Watch për Kosovën, fëmijët përbënin rreth 30% të viktimave civile të luftës.² Sipas të dhënave të Komisionit Komunal për të Zhdukurit në Kuvendin Komunal të Malishevës dhe Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, 40 banorë (38 meshkuj dhe 2 femra) në komunën e Malishevës nuk kanë njohur fatin e tyre pas luftës. Këta banorë janë konsideruar të pagjetur, ngaqë nuk janë gjetur trupat e tyre, ose prova të tjera të vdekjes. Kjo është një dëshmi e mëtejshme e pasojave të luftës dhe e sfidave që mbeten për familjet e atyre që ende nuk kanë marrë përgjigje për

¹ Arkivi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, Komuna e Malishevës, Regjistri i personave të vrarë gjatë luftës nga forcat serbe, fl. 1-6, cituar në Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, vëll. 1 (Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012), 551-559. Konsultim me Liridon Hotin, drejtor i Punës dhe Mërqinjës Sociale, Komuna e Malishevës, 7 dhjetor 2020.

² Hanumshahe Ilazi & Nustret Pllana, *Fëmijët martirë të Kosovës, 1981* (Prishtinë: Radio-Kosova e Lirë, 2019), 135-147. Shih listën e plotë të fëmijëve.

të dashurit e tyre.³

Në këtë komunë, janë gjetur më shumë se 16 varreza masive, ku janë varrosur trupat e viktimave të masakrave të ndodhura gjatë luftës. Këto masakra dhe varreza masive dëshmojnë për nivelin e lartë të krimit të luftës dhe gjenocidit që është bërë në këtë komunë.⁴ Në komunën e Malishevës, dhjetëra civilë shqiptarë të pafajshëm janë vrarë ose plagosur gjatë luftës. Sipas Shoqatës së Invalidëve të Luftës në Malishevë, më shumë se 250 civilë nga kjo komunë kanë mbetur me plagë të rënda fizike dhe psikologjike, të cilat kanë ndikuar negativisht në jetëgjatësinë dhe cilësinë e jetës së tyre.⁵ Popullata civile ka pësuar krime të rënda, të cilat kanë prekur individë të ndryshëm sipas moshës dhe gjinisë. Sipas të dhënave zyrtare, numri i viktimave të vrara është si më poshtë:

- 10 fëmijë të dy gjinive me moshë nga 0 deri në 7 vjeç,
- 15 fëmijë të të dy gjinive me moshë nga 8 deri në 14 vjeç,⁶
- 25 persona me moshë nga 15 deri në 18 vjeç,
- 159 burra dhe gra me moshë nga 19 deri në 60 vjeç,
- 94 burra dhe gra me moshë mbi 60 vjeç.⁷

Komuna e Malishevës ishte një nga zonat më të goditura nga lufta e Kosovës në vitin 1999, kur forcat serbe kryen një sërë krimeve kundër njerëzimit ndaj popullsisë shqiptare. Sipas raporteve të organizatave të ndryshme të drejtave të njeriut, si Human Rights Watch dhe Amnesty International, forcat serbe kanë vrarë, arrestuar, torturuar dhe dëbuar nga shtëpitë e tyre qindra civilë shqiptarë, duke përfshirë edhe nxënës të shkollave të mesme (shumë prej tyre ishin pjesë e Lëvizjes Rinore të Kosovës, një organizatë që luftonte për arsimim në gjuhën shqipe). Njëkohësisht, forcat serbe kanë shkatërruar dhe bllokuar infrastrukturën shëndetësore në komunë, duke lënë pa ndihmë mjekësore shumë fëmijë, gra dhe të moshuar shqiptarë. Këto veprime kanë krijuar një situatë humanitare

³ Arkivi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, Komuna e Malishevës, Regjistri i personave të zhdukur gjatë viteve 1998-1999, fl. 1-2, cituar në Sinan Gegaj et al., Raporti i Komisionit për të Zhdukurit në Komunën e Malishevës, 29 nëntor 2007.

⁴ *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, vëll. 1, red. Jusuf Osmani (Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012), 272.

⁵ ADSSHMSM, Regjistri i personave të vrarë gjatë luftës nga forcat serbe, 1998-1999, fl.1-6. Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999*, I, 551-559. Këto të dhëna janë mbështetu dhe në konsultim me drejtorin e Punës dhe Mërqinjës Sociale, z. Liridon Hotin, Malishevë, 07.12.2020, ora 10:30-12:00.

Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, Monografi I (Prishtinë: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, 2010), 44.

⁷ *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, Monografi I, 44-45.

shumë të rëndë në komunën e Malishevës; sipas Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, rreth 50 mijë persona kanë qenë në nevojë për ushqim, ujë, ilaçe dhe strehim.⁸

Analiza e ngjarjeve dhe pasojave të sulmit të parë në Malishevë gjatë luftës në Kosovës

Në verën e vitit 1998, komuna e Malishevës u bë skenë e një sulmi të ashpër të forcave serbe kundër popullsisë shqiptare. Më datën 28 korrik 1998, një ofensivë ushtarake dhe policore serbe, e përbërë nga dhjetëra tanke dhe mjete të blinduara, hyri në disa fshatra të komunës së Malishevës duke filluar nga Bubaveci, Terpezë e Ulët e Caralluka dhe vazhdoi drejt qendrës së Malishevës. Aksioni u shoqërua me bombardime të vazhdueshme nga distanca nga forcat serbe, të cilat kishin si synim të shpërndanin dhe terrorizonin banorët civilë. Shumica e popullatës civile kishin braktisur fshatrat pranë rrugës dhe kishin shkuar në zona më të largëta për të shpëtuar nga sulmet serbe. Ata që kishin mbetur u detyruan të iknin nga granatimet e vazhdueshme. Kur forcat serbe hynë në fshatrat Bubavec, Terpezë e Ulët e Carallukë u vranë 8 civilë të paarmatosur* dhe vazhduan drejt qendrës së Malishevës, ku shkatërruan çdo gjë me zjarr.⁹ Ky ishte rasti i parë i një vrasjeje kolektive të qytetarëve civilë shqiptarë në këtë komunë.

Masakra e Senikut

Gjatë luftës në Kosovë, shqiptarët në komunën e Malishevës kanë pësuar një dhunë të tmerrshme nga forcat serbe, të cilat kanë sulmuar fshatrat e tyre me armë të rënda dhe kanë vrarë, plagosur dhe dëbuar nga shtëpitë e tyre familje të tëra shqiptare. Këto krime kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në jetët e të mbijetuarve dhe kanë shkelur të drejtat e njeriut

⁸ Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, Monografi I, 299.

* Fetah B. Gashi (1912-28.07.1998) i vrarë në vendlindje Bubavec; Ramadan S. Hoti (81) nga Caralluka, Jashar Sh. Krasniqi (51); Rasim D. Krasniqi (1940-28.07.1998) dhe Demush D. Krasniqi (1933-28.07.1998) janë varë në vendlindjen e tyre në fshatin Terpezë të Uëtë; Hysen F. Krasniqi (1935-28.07.1998) i vrarë në vendlindje në Llashkadrenoc; Ajjet R. Krasniqi (1947-27.08.1998) i vrarë në vendlindje në Terpezë të Ulët; Ismet M. Krasniqi (1956-29.07.1998) i vrarë në vendlindje në Lloshakdrenoc; AD SHMSM, Regjistri i personave të vrarë gjatë luftës nga forcat serbe 1998-1999, fl.1-6; Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, Monografi I, 964.

⁹ Arkivi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Malishevës, Regjistri i personave të vrarë gjatë luftës nga forcat serbe 1998-1999, fl. 1-6, cituar në *Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999*, vëll. 1, red. Jusuf Osmani (Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012), 964.

dhe normat ndërkombëtare. Ndër aksionet më të mëdha që ushtria dhe policia serbe kanë ndërmarrë ndaj fshatrave shqiptare të komunës së Malishevës është edhe aksioni në fshatin Senik.

Masakra e Senikut është një nga shembujt më të qartë të krimit të luftës dhe gjenocidit të kryer nga Serbia në komunë e Malishevës. Konsiderohet një ndër masakrat më të mëdha në Kosovë deri në këtë periudhë kohore.¹⁰ Në këtë fshat, në periudhën nga muaji maj deri në gusht 1998 u strehuan të zhvendosurit nga Drenica dhe Rahoveci si dhe banorë që ishin përqark rrugëve kryesore të rajonit të Malishevës.¹¹ Të përndjekurit nga zonat e luftës të vendosur në fshatin Senik krahas shtëpive të banimit, u detyruan të vendoseshin edhe në objektin e shkollës.

Sipas të dhënave, gjatë muajve të verës në këtë fshat janë vendosur mbi dymijë të shpërngulur nga fshatrat përreth.¹² Më datën 24 gusht 1998, pjesëtarët e Ushtrisë Jugosllave erdhën nga drejtimi i Malishevës dhe u stacionuan në vreshtat e ndërmarrjes “Mirusha”, në afërsi të fshatrave Senik, Bajë dhe Bellanicë. Për shkak të rrezikut që kanosej, banorët e fshatit dhe refugjatët që gjendeshin në Senik e braktisën fshatin.¹³ Në mesin e të larguarve nga fshati Bajë ishte dhe Sofije Shala*, e cila për shkak të granatimeve nga fshati Bajë ishte strehuar në fshatin Senik.¹⁴ Banorët e Senikut nuk shkuan shumë larg, por u vendosën në tri pjesë të malit të fshatit: te Mrizet, te Bahqja e Hasan Dautit dhe te Lugu i Bareve. Kjo ishte hera e dytë që senikasit u larguan nga shtëpitë e tyre. Nga 25 deri më 27 gusht 1998 (dy net) banorët e këtij fshati si dhe të përndjekurit nga lufta kanë fjetur në male. Më 27 gusht 1998, forcat serbe pasi hynë në fshatin Kleçkë, iu drejtuan civilëve që qëndronin në malet e Senikut. Rreth orës 16:00, forcat e ushtrisë dhe policisë serbe granatuan fshatin mbi civilët e strehuar në male, me artileri të rëndë nga disa drejtime. Nga këto granatime u vranë nëntë civilë, në mesin e tyre gra, fëmijë dhe pleq, ndërsa u plagosën

¹⁰ Krimet e luftës në Kosovë, 1, 49.

¹¹ Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, vëll. 1 (Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012), 532.

¹² Fondacioni për të Drejtën Humanitare, *Libër Kujtimi i Kosovës, 1998-2000, Libri i Parë* (Prishtinë: 2011), 223.

¹³ Fondacioni për të Drejtën Humanitare, *Libër Kujtimi i Kosovës, 1998-2000, Libri i Parë*, 223-224.

* Sofija ishte plagosur në Senik dhe në këtë masakër djalnin i saj Xhafer Shala nëntë muaj jetë është vrarë dhe tani konsiderohet i zhdukur. Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, Monografi I, 967-968.

¹⁴ Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, Monografi I, 49

50 civilë të tjerë.¹⁵

Gjatë bombardimit, të mbijetuarit u tërhoqën në thellësi të malit (shkuan tek Lugu i Bareve), ndërsa të vrarët mbetën në vend. Në mbrëmjen e 27 gushtit, kur bombardimi pushoi, Hajrulla Ramaj mori trupin e pajetë të nënës së tij (Hyrije Ramës) dhe trupin e nipit të tij pesëvjeçar (Altin Ramës), të cilët i solli në shtëpinë e tij, për t'i varrosur.* Trupat e të vrarëve të tjerë kanë mbetur në pyll edhe të nesërmen, pra deri më 28 gusht, ngase forcat serbe u vënin zjarrin traktorëve me rrobat dhe ushqimet që kishin mbetur pas ikjes së turmës së njerëzve (nga Mrizet).¹⁶

Më 29 gusht 1998, në praninë e përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, banorët e fshatit Senik i kanë bartur në fshat trupat e Zadës, Halimës, Elvanës, Valentinës dhe Sevdijës dhe i kanë vendosur në shtëpinë e Hafir Zulfaj. Ndërsa trupin e Xhaferit të vogël (disamujsh) nuk e kishin gjetur në vendin ku e kishin lënë para dy ditësh (më 27 gusht). Më 30 gusht, në prani të OSBE-së, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) dhe të Mjekëve pa Kufij, banorët dhe familjarët varrosën në mal (te Mrizet) Halimën, Zadën, Elvanën, Valentinën dhe Sevdijën,¹⁷ ndërsa më 1 shtator, Hajrulla Ramaj varrosi nënën dhe nipin e tij tek varrezat e lagjes. Në ditën kur u vranë civilët shqiptarë në malet e Senikut, banorët (mbi 2 000) u larguan nga aty dhe u kthyen në fshat, edhe pse pjesa më e madhe e shtëpive të tyre ishin të djegura dhe të demoluara. Të nesërmen, pra më 28 gusht 1998, ushtria serbe nga Kleçka granatoi përsëri fshatin Senik. Nga granatimi i fshatit, më së keqi e pësoi familja e Haxhi-Smajlëve, e cila tashmë ishte e strehuar në shtëpitë e tyre të vjetra. U plagosën mbi 20 anëtarë të kësaj familjeje, por plagët më të rënda i mori Vezirja (gruaja e Smajlit) dhe Kujtimi (nga Astrazubi, që ishte nip i Smajlit). Kujtimin e plagosur e morën dy vëllezërit e tij, Urimi dhe Avniu dhe e dërguan në Bellanicë. Ndërsa Vezirën dhe të plagosurit e tjerë i dërguan në shtëpinë e Misin Jonuzajt (rreth 200 metra në jug të vendit të ngjarjes). Edhe pse e plagosura me emrin Vezire, e mori ndihmën e parë nga Shpresa Jonuzaj, që ishte motër medicinale, por nuk i mbijetoi plagëve dhe për pasojë të nesërmen në mëngjes ndërroi jetë. Po atë ditë u bë edhe varrimi i saj. Për të plagosurit e tjerë, u kujdesën përfaqësuesit e KNKK-së, të cilët më 29 gusht i dërguan në

¹⁵ Fondacioni për të Drejtën Humanitare, Libër Kujtimi i Kosovës, 1998-2000, Libri i Parë, 223-224.

* Trupat e tyre u varrosën më 1 shtator. Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga PhD. Halil Brahaj i cili është duke përgatitur një monografi për fshatin Senik.

¹⁶ Sipas Time Ramaj, dëshmitar i masakrës së Senikut, cituar në Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, vëll. 1, red. Jusuf Osmani (Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012), 967.

¹⁷ Po aty. 224.

spitalin e Prishtinës.

Por, fatkeqësisht Kujtimi nuk arriti t'i mbijetojë plagëve të marra dhe sapo mbërriti në spital, ndërroi jetë.¹⁸ Vrasjet dhe ekzekutimet e civilëve shqiptarë në komunën e Malishevës vazhduan edhe pas kësaj. Më 1 shtator 1998, Skënder Jonuzaj u plagos në shpinë dhe në këmbën e majtë nga predhat e forcave serbe që e qëlluan nga Kleçka. Familjarët e futën në bodrum duke tentuar që t'i jepnin ndihmë, por ai vdiq pas dy orësh. Atë ditë Skënderin e kanë varrosur tek Zabeli i Idrizit¹⁹ dhe pas luftës, është rivarrosur në varrezat e fshatit. Po ashtu, më 5 shtator 1998, një snajperist serb, duke gjuajtur nga Kleçka, kishte qëlluar mbi plakun Brahim Himë Zulfaj (74-vjeçar) duke e lënë të vdekur. Po atë ditë u bë varrimi i tij në një livadh, ndërsa më 12 tetor 1999 (pas luftës), është rivarrosur në varreza të fshatit.²⁰ Të gjitha këto vrasje u bënë nga forcat serbe që ishin të vendosura në Kleçkë.

Civilët e vrarë në masakrën e Senikut

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Data e vrasjes	Vendbani mi
1.	Halime Jakup Halitaj	03. 11. 1981	Senik	27. 08. 1998	Senik
2.	Hyrë Rrustem Ramaj	13. 06. 1919	Senik	27. 08. 1998	Senik
3.	Alitin Malush Ramaj	25. 02. 1993	Senik	27. 08. 1998	Senik
4.	Vezire Hajdin Suka-Zulfaj	07. 07. 1954	Senik	28. 08. 1998	Senik
5.	Brahim Himë Zulfaj	11. 03. 1924	Senik	05. 09. 1998	Senik
6.	Skënder Azem	05. 01. 1970	Senik	01. 09. 1998	Senik

¹⁸ Fondacioni për të Drejtën Humanitare, Libër Kujtimi i Kosovës, 1998-2000, 225.

¹⁹ Fondacioni për të Drejtën Humanitare, Libër Kujtimi i Kosovës, 1998-2000, 225-226.

²⁰ Fondacioni për të Drejtën Humanitare, Libër Kujtimi i Kosovës, 1998-2000, 227.

	Januzaj				
7.	Sahit Tahir Halitaj	25. 08. 1932	Senik	02. 04. 1999	Senik ²¹
8.	Zade Hasan Halitaj – Karaçica	05. 10. 1936	Balincë	27. 08. 1998	Balinicë
9.	Elvane S. Shala	03. 06. 1960	Bajë	27. 08. 1998	Bajë
10.	Valentina S. Shala	25. 08. 1987	Bajë	27. 08. 1998	Bajë
11.	Xhafer Fadil Shala ²²	09. 12. 1997	Bajë	27. 08. 1998	Bajë
12.	Sevdije Ramë Krasniqi	1974	Carallukë	27. 08. 1998	Carrallukë
13.	Fitim Llugaliu	1998	Javor	27. 08. 1998	Javor
14.	Kujtim Rifat Morina	15. 03. 1986	Astrazub	28. 08. 1998	Astrazub ²³

Sa i përket aspektit gjinor të të vrarëve dhe të të ekzekutuarve në fshatin Senik, nga gjithsej 14 civilë, 7 prej tyre janë vajza dhe gra dhe 7 të tjerë janë të gjinisë mashkullore. Po ashtu, i barabartë është edhe numri sa i përket vendbanimit: 7 janë vendas (nga Seniku) dhe 7 janë mysafirë (në fakt ishin të shpërngulur nga shtëpitë e tyre). Sipas dëshmitarëve që kanë arritur t'i shpëtojnë krimeve të forcave serbe, të gjithë të ekzekutuarit ishin civilë dhe të paarmatosur, të cilët u vranë nëpër shtëpitë dhe pranë familjeve të tyre. Krahas të vrarëve në masakrën e Senikut, kanë mbetur të plagosur dhe dhjetëra civilë të pafajshëm. Vlen të përmendet se nga numri total i të plagosurve në fshatin Senik më 27 dhe 28 gusht 1998 dhe 4 qershor 1999, sa

²¹ Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informativë “Kosovapress”, Vëllimi i Tretë (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016), 200.

²² Trupi i tij nuk është gjetur deri më sot. Dyshohet se ai është djegur dhe karbonizuar, ose është rrëmbyer nga forcat serbe.

²³ ADSHMS, Regjistri i personave të vrarë gjatë viteve 1998-1999. fl.1-6; Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, Monografi I, 966.

i përket aspektit gjinor 28 janë vajza dhe gra, apo në përqindje 54.19%, ndërsa 22 janë djem dhe burra, apo 45.81%. Ndërsa, sa i përket vendbanimit, 28 janë vendas nga Seniku (58.47%), kurse 21 janë mysafirë (41.53 %).²⁴

Masakra në Gullubovc

Masakra e Gullubovcit u krye më 26 shtator 1998, nga forcat ushtarake dhe policore serbe dhe është masakra e tretë me radhë e bërë në komunën e Malishevës, masakra me numrin më të madh të të vrarëve në këtë komunë deri në këtë periudhë. Një ditë para masakrës, më 25 shtator, forcat policore dhe ushtarake serbe nga largësia gjuajtën me armë të rënda fshatrat Plloçicë dhe Gullubovc, me qëllim të dëbimit të popullsisë. Gjuajtjet dhe granatimet u bënë nga drejtimi i Kjevës ku ishin të vendosura forcat serbe. Banorët e fshatit Plloçicë u larguan dhe shkuan në drejtim të fshatit Gullubovc, respektivisht në drejtim të Grykës së Gullubovcit ku ishin të vendosur dhe shumë banorë të këtij fshati, por dhe të fshatrave të tjera që ishin të vendosur këtu për t'u strehuar. Forcat serbe u futën në brendi të fshatit dhe hynë në mesë të popullatës duke e rrethuar dhe duke shkaktuar panik në mesin e tyre.²⁵

Fillimisht, forcat serbe i ndanë disa burra nga familjarët e tyre dhe i kidnapuan, për t'i dërguar më pas në një oborr të lagjes “Hoxhaj”, konkretisht në shtëpinë e Miftar Mujë Hoxhës, ku i keqtrajtuuan deri në vdekje. Pas torturave të shumta fizike dhe psikike, u ekzekutuan 13 persona. Kësaj masakre i ka mbijetuar vetëm Selman Morina, i cili ishte i plagosur, por nën trupat e të tjerëve arriti të shpëtojë. Sipas dëshmitarëve të kohës që kanë arritur t'i shpëtojnë krimeve të forcave serbe, të gjithë të ekzekutuarit ishin civilë dhe të paarmatosur, të cilët u vranë nëpër shtëpitë dhe pranë familjeve të tyre.²⁶

Civilët e vrarë në fshatin Gullubovc

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Vendbanimi	Data e vrasjes	Vendi i vrasjes
1.	Delij B.	1938	Plloçicë	Plloçicë	26.09.19	Gullubovc

²⁴ Të dhënat për të plagosurit i kemi marrë nga Qendra për Informim e Kosovës (dega në Suharekë), nga Jakup Halitaj dhe nga Hajrulla Ramaj (shkurt 2015).

²⁵ Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë*; 531.

²⁶ *Po aty*.

	Gashi				98	
2.	Bedri F. Gashi	1969	Balincë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
3.	Sejdi B. Gashi	1940	Plloçicë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
4.	Selman Xh. Gashi	1968	Balincë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
5.	Ajet M. Maloku	1949	Plloçicë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
6.	Muhamet H. Maloku	1960	Plloçicë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
7.	Aziz H. Maloku	1949	Plloçicë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
8.	Jeton M. Maloku	1949	Plloçicë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
9.	Hazir O. Maloku	1922	Plloçicë	Plloçicë	26.09.1998	Gullubovc
10.	Rizah R. Maloku	1931	Plloçicë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
11.	Kajtaj S. Maloku	1926	Plloçicë	Plloçicë	26.09.1998	Gullubovc
12.	Ahemet Xh. Maloku	1944	Plloçicë	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
13.	Osman F. Morina	1973	Gullubovc	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc
14.	Hamëz R. Morina	1945	Gullubovc	Gullubovc	26.09.1998	Gullubovc

Trupat e viktimave, në veçanti fytyrat e tyre, ishin të gjymtuara. Gjatë ekzekutimit të civilëve shqiptarë, forcat serbe kishin lënë pas në vendin e krimit objekte të ndryshme si drunj të mbuluara me gjak, tërfurq, sëpata, zinxhirë etj. Individët që u masakruan ishin banorë të fshatrave Plloçicë (tetë persona), Gullubovc (katër persona) dhe Balincë (një person). Mosha e të vrarëve varionte nga 25 deri në 67-vjeçar.²⁷ Sipas dëshmive të

²⁷ Krimet e luftës në Kosovë, 1998-1999, Monografi I, 969-970.

Visare Malokut, pas largimit të forcave serbe, trupat e të vrarëve janë marrë me një traktor nga oborri i shtëpisë në vendin ku është kryer krimi dhe të gjitha viktimat janë varrosur në Gullubovc, në afërsi të livadheve ku ka qëndruar popullata. Varrimin e kanë bërë kryesisht të moshuarit dhe femrat, ndër to ka qenë dhe Ajshe Maloku e cila vetë e ka hapur varrin e babait të saj, ngaqë të afërmit i kishte në male.²⁸ Pas përfundimit të luftës të masakruarit janë rivarrosur në fshatin Plloçicë.²⁹

Sipas burimeve, një person* nga fshati Ploçicë është vrarë në Prishtinë. Përveç tri masakrave të mëparshme që u përmendën, që u kryen gjatë vitit 1998 në komunën e Malishevës, forcat ushtarake dhe policore serbe gjatë këtij viti kanë vrarë, ekzekutuar dhe masakruar në forma dhe vende të ndryshme rreth 100 civilë shqiptarë të paarmatosur. * Duhet të

²⁸ *Po aty*, 970-971.

²⁹ *Po aty*, 969-970.

* Halim I. Maloku, (1960-26.09.1998) nga fshati Plloçicë i vrarë në Prishtinë; Arkivi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Regjistri i personave të vrarë gjatë viteve 1998-1999. fl.1-6. Osmani, Krimet e Serbisë..., 556.

* Faik S. Dobruna (1975-04.04.1998) nga Llazica, i vrarë në Bj. Zatriqit; Blerim B. Dobruna (1979-05.04.1998) nga Llazica, i vrarë në fshatin Rezallë të Skënderaj; Muhamet D. Kelmendi (1929-08.05.1998); Nazif I. Kelmendi (1941-08.05.1998); Rexhep I. Kelmendi (1982-08.05.1998) të gjithë të vrarë në vendlindje në Balincë; Jahir B. Shabani (1960-17.05.1998) nga fshati Bubel, i vrarë në Dollavë; Ajet K. Gashi (1954-12.06.1998) nga Bubaveci, i vrarë në Malishevë; Vesel Z. Gashi (1925-11.07.1998) i vrarë në vendlindje në Balincë; Hysen R. Bibaj (1985-12.07.1998) i vrarë në vendlindje në Lladroc; Hasan B. Morina (1973-15.07.1998) nga Llashkadreni i vrarë në Llazicë; Vlorë M. Zogaj (11.07.1982-18.07.1998) e vrarë në vendlindje në Mleqan; Ahmet R. Kelmendi (1980-24.07.1998) i vrarë në vendlindje në Balicë; Xhevë K. Gashi (1925-15.07.1998) në vendlindje në Balincë; Dafina R. Mazreku (1994-25.07.1998) e vrarë në vendlindje në Malishevë; Ramiz M. Mazreku (1944-30.07.1998) i vrarë në vendlindje në Malishevë; Sadik O. Morina (1929-07 shtator 1998); Kujtim R. Morina (27.08.1998); Islam R. Morina (1930-30.07.1998; Nebih S. Thaqi (1928-01.08.1998) i vrarë në vendlindje në Shkarashnik; Brahim Sh. Begaj (1945-18.08.1998) i vrarë në vendlindje në Bajë; Sadri R. Gashi (1937-24.08.1998) i vrarë në vendlindje në Vërmicë; Dervish H. Maloku (1936-26.08.1998) nga Plloçica i vrarë në Gullubofc; Fazli H. Hoxha (1949-27.08.1998) në vendlindje në Gullubofc; Ismail A. Morina (1937-28.07.1998) i vrarë në vendlindje në Llashkadrenoc; Murat R. Kryeziu (1944-28.07.1998) i vrarë në Bubavec (vendlindja e tij). Gjithashtu në këtë fshat të nesërmen është vrarë dhe Bajram A. Kryeziu (1926-29.07.1998); Jashar I. Paqirizi (1853-29.07.1998) i vrarë në vendlindje në Dragobil; Valentina L. Maloku (1979-19.08.1998) e vrarë në vendlindje në Plloçicë; Ramadan M. Berisha (1925-27.08.1998) i vrarë në vendlindje në Lladroviq; Sevdie R. Krasniqi (1947-27.08.1998) nga Caralluka, e vrarë në Kleçkë; Jashar Sh. Krasniqi (1947-28.07.1998) i vrarë në vendlindje në Terpezë të Ulët; Mirije M. Vrenezi (15.06.1919-09.09.1998) dhe Vezire M. Vrenezi (15.06.1919-09.09.1998) të vrara në vendlindje në Marali; Osman M. Paqirizi (1930-18.09.1998) dhe Fehmi M. Paqirizi (1950-18.09.1998) të vrarë në vendlindje në Dragobil; Latif A. Javori (1929-20.09.1998) në vendlindje në Llazicë; Lulzim A. Gashi (1981-23.09.1998) i vrarë në

theksohet se mbi 99% e të vrarëve u ekzekutuan dhe u masakruan në vendlindjen e tyre, ose si të përndjekur në fshatrat e tyre apo vende tjera. Gjatë vitit 1998, për shkak të kushteve të rënda në male ku u strehuan dhe duke u zhvendosur nga njëri fshat në tjetrin për arsye dhe rrethana të luftës, pra në mungesë të kushteve elementare për jetë, kanë ndërruar jetë edhe dy fëmijë* të porsalindur.

Masakra në Burim (ish-Joviq)

Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi forcat ushtarake serbe, këto të fundit nisën një sulm të ashpër ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë.³⁰ Në vitin 1999, forcat ushtarake dhe policore serbe kryen një sërë aksionesh të dhunshme kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, duke shkaktuar viktima të shumta dhe dëme të rënda. Një nga zonat më të prekura nga këto aksione ishte komuna e Malishevës, ku u bë një nga masakrat më të mëdha të luftës. Në fshatrat e komunës së Malishevës, ndër aksionet më të mëdha që u ndërmorën, ishte ai në fshatin Burim, i cili për një kohë të gjatë ishte bërë vendstrehim për banorë shqiptarë të fshatrave përreth, ku u ekzekutuan dhe u masakruan shumë banorë të kësaj komune. Kështu, fshati Burim u bë një simbol i rezistencës dhe i vuajtjes së popullit shqiptar në Kosovë, që luftoi për lirinë dhe pavarësinë e vendit të tyre. Në këtë fshat ishin të strehuar rreth 8-10 mijë persona (kryesisht gra, pleq e fëmijë) të zhvendosur nga fshatrat përreth, si nga Astrazubi, Dragobili etj. Më 31 mars 1999, ata u bënë shënjestër e një aksioni të egër të forcave serbe. Këto forca, të përbëra nga ushtria, policia, forcat paramilitare dhe disa civilë, pasi

vendin e lindjes në Vërmicë; Ramadan I. Hoxha (1957-25.09.1998) i vrarë në vendlindje Gulluboc; Selam Rr. Kafexholli (1926-27.09.1998) i varë në vendlindje në Bellanicë; Selman A. Binishi (1970-02.10.1998) i vrarë në vendlindje në Bajë; Ramiz M. Hoxha (1935-02.10.1998) i vrarë në vendlindje në Bellanicë; Hasan D. Shala, (1979-20.05.1998) nga Baja; Sami V. Kryeziu (1980-15.10.1998) nga Pagarusha i vrarë në Pashtrik; Osman F. Krasniqi (1936-22.10.1998) në vendlindje në Lloshkadrenc; Shyqiri Sh. Krasniqi (1970-22.10.1998) i vrarë në vendlindje në Llashkadernoc; Xhafer S. Gashi (1950-12.11.1998) në vendlindje në Mleqan. Më gjerësisht shih: Arkivi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, në Komunën e Malishevës, Regjistri i personave të vrarë gjatë luftës nga forcat serbe, fl.1-6. Osmani, Krimet e Serbisë., 551-559. Hanumshahe Ilazi & Nustret Pllana, Fëmijët martirë të Kosovës, 1981, Prishtinë: Radio-Kosova e Lirë, 2019, 135-147. Shih listën e plotë të fëmijëve; Këto të dhëna janë mbështetu dhe në konsultim me drejtorin e PMS, z. Liridon Hotin, Malishevë, 07.12.2020, ora 10:30-12:00.

* Dorentinë Krasniqi (1997-24.07.1998) nga Lloshkadreni e vdekur në Berishë; Kujtesa A. Hajdaraj (1998-05.09.1998) në vendlindje në Llapçevë dhe ishte vetëm 6-muajshe. Hanumshahe Ilazi & Nustret Pllana, Fëmijët martirë të Kosovës, 135-147. Shih listën e plotë të fëmijëve të vrarë nga komuna e Malishevës.

³⁰Buletini, Viti. IX, Nr.11-12 (mars-shtator 1999) (Prishtinë: KMDLNJ), 5.

granatuan fshatin, filluan të plaçkitin dhe të vrasin popullatën civile, duke u marrë para, ari dhe çdo gjë më vlerë. Viktimat ishin banorët e këtij fshati dhe të atyre që ishin strehuar këtu (fshati Burim kishte një xhami të madhe, ku shumë njerëz kishin gjetur strehim). Pas plaçkitjes dhe torturave psikike dhe fizike, forcat serbe i ndanë 40-50 persona nga popullata, ku disa prej tyre u liruan, ndërsa disa të tjerë u dërguan në Carravranë (Gurbardh), ku ishin dhjetëra, mijëra të strehuar.³¹

Në këtë vrasje, brenda një dite, u masakruan 34 persona. Në orët e vona të asaj nate, forcat serbe u kthyen në vendin e krimit dhe i shpërndanë trupat e viktimave në periferi të fshatit, rreth 20-30 metra nga njëri-tjetri.³² Në këtë masakër u varën persona të të dy gjinive dhe moshave të ndryshme, duke mos u kursyer as fëmijët, gratë dhe të moshuarit (ata ishin nga moshë 16 deri në 72 vjeç). Vetëm një person, Nuredin Amrush Morina³³, ka shpëtuar nga kjo masakër.

Lista e emrave të civilëve të vrarë e të ekzekutuar në masakrën e Burimit (ish-Joviq)

Nr.	Emri mbiemri	Viti i lindjes	Vendlindja	Gjinia	Mosha
1.	Milazim A. Mornia	1939	Astrazup	M	60
2.	Hamzë A. Morina	1929	Astrazup	M	70
3.	Hasan A. Morina	1927	Astrazup	M	72
